



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 592/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.12.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-68090-08-09-2020, me objekt “*Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore*” - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (24 muaj)”, me fond limit 4.800.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Krujë.”

Ankimues: “Medi Tel” sh.p.k.
Autostrada Tiranë – Durrës, Km.1, Rruga “Vidhe Gjata”, Nr.18,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Krujë
Rruga “Nënë Tereza”, Krujë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.08.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-68090-08-09-2020, me objekt “Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore” - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (24 muaj)”, me fond limit 4.800.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Krujë.

II.2. Në datën 09.10.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 29.10.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------------------|------------------------------|
| 1. “Medi - Tel” sh.p.k. | 1.900.000 lekë, skualifikuar |
| 2. “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. | 2.100.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “Pura Medical” sh.p.k. | 2.700.000 lekë, skualifikuar |
| 4. “Eco Riciklim” sh.p.k. | 3.750.000 lekë, skualifikuar |

II.4. Në datën 29.10.2020 operatori ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

1. Bazuar ne piken 2.4.5 te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit te DST “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill te licensuar per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive ne momentin e hapjes se ofertave dhe e vlefshme për minimalisht 12 muaj pas hapjes se ofertave”, OE ka paraqitur Akt –Marreveshje, per landfill, te lidhur me INTEGRATED TECHNOLOGY BV SPV sh.p.k. me date 15.01.2020, ku ne nenin 3 pika 1, percaktohet: "Palet bien dakort qe kjo akt marreveshje eshte me afat 1 (nje) vjecar..." nga sa me lart operatori ekonomik Medi Tel shpk nuk permbush kriterin e pikes 2.4.5 qe te kete kontrate te vlefshme me nje landfill per me shume se 12 muaj, duke qene se vlefshmeria e kontrates perfundon me 15.01.2021. Gjithashtu Vertetimi nr.238, date 10.08.2020 leshuar nga INTEGRATED TECHNOLOGY BV SPV, paraqitur nga Medi Tel shpk, verteton vlefshmerine 1 vjecare nga momenti i lidhjes, dhe nuk mund te merret si prove per tejzjatjen, apo premtim per lidhjen e nje kontrate ne te ardhmen, por eshte vetem konfirmim i kontrates ne fuqi mes paleve.

2. Formulari i ofertes, nga operatori ekonomik Medi-Tel, eshte paraqitur ze per ze, nderkohe qe duke pare formatin e shtojces nr 1, eshte kerkuar te paraqitet oferte per totalin e kilogrameve, duke qene se sasite jane te peraferta dhe nuk jane dhene fiks, dhe formulimi i ofertes ne kete forme mund te sjelle dem ekonomik per AK gjate zbatimit te kontrates duke qene se ndonjeri nga zerat me cmim me te larte mund te kete sasi me te madhe nga sa eshte parashikuar, cka do rriste cmimin e kontrates. Kjo e konstatareshme edhe ne piken 2.8, faqe 3 te DST duke qene se nuk eshte plotesuar shumatorja e çmimeve për njësi nga AK, neqoftese objekti i prokurimit do te perbehej nga disa artikuj zeri 2.8 do te ishte plotesuar.

II.5. Në datën 02.11.2020 operatori ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]

Nisur nga arsyetimi I AK-se, ne e gjykojme si të padrejte skualifikimin tone pasi:

1.OE Medi Tel sh.p.k. disponon një Akt-Marreveshje (kontratë) te lidhur me një landfill të licensuar (Integrated Technology BV SPV sh.p.k.) për depozitimin e produktit final që del nga trajtimi, e cila eshte aktive në momentin e hapjes së ofertave. Gjithashtu OE Medi Tel sh.p.k. bashke me akt – aktmarrëveshjen ka paraqitur edhe një vërtetim nr. 238 datë 10.08.2020 lëshuar nga Integrated Technology BV SPV sh.p.k. në të cilin citohet: “Shoqëria koncensionare

“Integratek Energy Bv Spv” vërteton se rinovimi I kësaj akt – marrëveshje bëhet cdo vit nëse janë respektuar të gjitha kushtet e saj”.

AK pretendon se paraqitja e vertetimi nr. 238, date 10.08.2020 lëshuar nga Integrated Technology BV SPV, paraqitur nga Medi Tel sh.p.k., vërteton vlefshmërinë I vjecare nga momenti i lidhjes dhe nuk mund të merret si prove për tejzgjatjen, apo premtim për lidhjen e një kontrate në të ardhmen, por është vetëm konfirmim i kontratës në fuqi mes palëve. Por në të vërtetë ky vërtetim vërteton pikërisht rinovimin e kësaj kontrate pas përfundimit të saj dhe vlefshmërinë e kësaj kontrate ekzistuese dhe jo sic është shprehur AK se vërteton vetëm vlefshmërinë e saj, kjo e verifikueshme lehtësisht duke lexuar vërtetimin nr 238 date 10.08.2020.

Gjithashtu Medi Tel sh.p.k. sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për tu siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”. Për këtë arsye argumentimi I AK nuk qëndron.

2. Lidhur me argumentimin e AK se Formulari i Ofertës Ekonomike paraqitur nga Medi Tel shpkeshite paraqitur ze per ze, nderkohe qe duke pare formatin e shtojces nr 1, eshte kerkuar te paraqitet oferte per totalin e kilogrameve, duke qene se sasite jane te peraferta dhe nuk jane dhene fiks, dhe formulimi i ofertes ne kete forme mund te sjelle dem ekonomik per AK gjate zbatimit te kontrates duke qene se ndonjeri nga zerat me cmim me te larte mund te kete sasi me te madhe nga sa eshte parashikuar, cka do rriste cmimin e kontrates. Kjo e konstataueshme edhe ne piken 2.8, faqe 3 te DST duke qene se nuk eshte plotesuar shumatorja e çmimeve për njësi nga AK, neqoftese objekti i prokurimit do te perbehej nga disa artikuj zeri 2.8 do te ishte plotesuar, ju bëjmë me dije se ashtu si dhe është shprehur KVO-ja, ka qenë vete AK ne formularin e shtojces nr 1, që i ka paraqitur të ndara sasitë dhe jo një sasi totale. Nëse shihet formulari I shtojca nr.1, verëhet lehtësisht se AK ka bere ndarje të sasive për cdo kategori (kod) të mbetjeve duke u nisur nga rendesia dhe rrezikshmeria qe keto lloj mbetjesh kane dhe ne fund ka shenuar edhe sasine totale. Nese AK do kerkonte vetem nje oferte per sasine totale, nuk kishte pse i shenonte sasite edhe te ndara per secilen kategori edhe sasine totale. Nisur nga kjo ne si OE për të shmangur cdo keqkuptim apo keqinterpretim qe mund te vinte si pasoje e kësaj, dhe per tui permbajtur me përpikmeri formularit të shtojces nr.1, i kemi plotësuar të dyja opsionet sic jane kërkuar nga AK, edhe cmimin për cdo kategori (kod), por edhe cmimin total ku është shkruar pesha totale nga AK. Në këtë rast AK mund të marre ne konsiderate cilin opsion preferon, pasi ka qene vete AK qe e ka kerkuar ne kete menyre formularin ne shtojcen nr.1 dhe ne si OE I jemi permbajtur ketij formati. Nisur nga kjo argumentimi I AK nuk qëndron.

Nisur nga sa me siper kerkojme qe AK te rivleresoje oferten tone duke e vleresuar ate si te vlefshme.

II.6. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pretendon se nuk ka marrë kthim përgjigje nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e tij. Ndërkohë që, referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, është bashkëlidhur edhe dokumenti me nr.1043 prot, datë 09.11.2020, e objekt “Kthim përgjigje për ankesën e datës 02.11.2020”, ku autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k., duke e refuzuar atë me pretendimin si më poshtë:

[...]

1. Ne lidhje me ankimin e OE Medi Tel per skualifikimin e tij per mosplotesim te kriterit 2.4.5 të shtojces 7: KVO ka skualifikuar OE Medi Tel sepse nuk ploteson kriterin 2.4.5 te shtojces DST “Operatori ekonomik duhet te paraqese nje kontrate te lidhur me nje landfill te licensuar per depozitim e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive ne momentin e hapjes se ofertave dhe e vlefshme minimalisht 12 muaj pas hapjes së ofertave”.

OE Medi – Tel ka paraqitur Akt – Marreveshje, për landfill, të lidhur me Integrated Technology BV SPV sh.p.k. të dates 15.01.2020, ku ne nenin 3 pika 1, përcaktohet: “Palet bien dakort që kjo aktmarreveshje eshte me afat 1 (nje) vjecar...” nga sa me lart operatori ekonomik Medi Tel sh.p.k. nuk permbush kriterin e pikes 2.4.5 qe te kete kontrate te vlefshme me nje landfill per më shume de 12 muaj, duke qene se vlefshmeria e kontrates perfundon me 15.01.2021. gjithashtu Vertetimi nr. 238, date 10.08.2020 lëshuar nga Integrated Technology BV SPV, paraqitur nga Medi Tel sh.p.k., vërteton vlefshmerine 1 vjecare nga momenti i lidhjes dhe nuk mund te merret si prove per tejzgjatjen, apo premtim per lidhjen e nje kontrate në te ardhmen, por eshte vetem konfirmim I kontrates ne fuqi mes paleve.

OE Medi Tel pretendon se ky vertetim verteton rinovimin e kesaj kontrate pas perfundimit te saj dhe vlefshmerine e kesaj ekzistuese dhe jo sic eshte shprehur AK se verteton vetem vlefshmerine e saj, kjo e verifikueshme duke lexuar vertetimin nr. 238 date 10.08.2020.

Se pari, duhet te shpjegojme etimologjine e fjalëve:

Kontratë – marreveshje me shkrim ndermjet dy paleve, ku percaktohen kushtet, detyrimet dhe te drejtat ligjore perkatese; dokumenti qe permban kete marreveshje: kontrata e qerese bej (lidh) kontraten.

Vertetim – pohoj pasi e kam shqyrtuar ose provoj me fakte se dicka eshte e vertete; tregoj se nje dokument eshte i sakte duke e nënshkruar; vërtetoj: e vërtetoi me shkrim; vërtetoj dyshimin; e ka vërtetuar jeta (shkenca); vërtetoi faturën; vërtetoj një teoremë

Nisur nga etimologjia e fjalës vërtetimi nuk është kontratë, I cili nuk është as premtim, as parakontrate, pra është pa vlerë ligjore.

Së dyti, parashikimi ligjor: Kontrata është parashikuar ne nenet 659 e vijues te “Kodit Civil”, me anë te cilit rregullohen marrëdhëniet e ndërsjellta ndërmjet paleve, e cila ka vlere ligjore mes dy paleve, e cila eshte nënshkruar dhe vulosur nga dy pale të cilat mbajne pergjegjesi te plote ligjore per detyrimet e ndersjellta qe sjell kontrata. Vertetimi nuk është parashikuar si marrëdhënie juridike, apo si detyrime mes një apo disa paleve, madje nuk ekziston si figure juridike kontraktuale dhe as ka vlere juridike apo ligjore ndersa ne DST eshte kerkuar nje kontrate mes paleve.

Nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve, por edhe në dosjen e tenderit, konstatohet se ne oferten elektronike te paraqitur nga subjekti ofertues Medi Tel shpk, për këtë tender, mungon dokumentacioni perkates per plotesimin e kriterit per kualifikim të përcaktuar ne piken 2.4.5 të shtojces 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, të DST, specifikisht ne lidhje me kërkesën që “..Operatori ekonomik duhet te paraqese një kontrate të lidhur me një landfill të licensuar për depozitim e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive ne momentin e hapjes së ofertave dhe e vlefshme per minimalisht 12 muaj pas hapjes se ofertave” ...”. Kontrata, që OE Medi Tel sh.p.k., disponon me Integrated Energy SPV sh.p.k. e dates 15.01.2020, përfundon me date 15.01.2020, pra nuk ka vlefshmeri 12 mujore nga hapja e ofertave dhe AK nuk ka parashikuar qe ky kriter mund e permbushet me nje vertetim.

Ne nenin 46, pika 1, të LPP, I ndryshuar parashikohet [...].

Gjithashtu në nenin 53, pika 3 e LPP i ndryshuar parashikohet [...].

Në dokumentat standarte të tenderit, pika II Udhezime për operatorët ekonomike, Seksioni z “Hartimi I ofertes”, pika 1.1, thuhet: “Operatorët ekonomike janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në keto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me keto DT do të refuzohen sipas e papranueshme”.

Autoriteti kontraktor, në analizën dhe shqyrtimin që i bëri ankesës dhe pretendimeve të parashtruara në atë, bazohet totalisht në dispozitat e sipërcituara ligjore, në rregullat e prokurimit, në kriteret apo kushtet e përcaktuara në DST, si dhe në qendrimet ligjore dhe të konsoliduara që ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), në trajtimin që kjo e fundit I ka bërë ceshtjeve të ngjashme, ku janë shtjelluar dhe argumentuar analiza dhe vendimarrja, që ajo i ka bërë pretendimeve të ngjashme, të paraqitura nga ankimuesi të ndryshëm [...] Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor të ofertenë e operatorit ekonomik të pavlefshme, si dhe përben kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, pra nga gara, sic përcaktohet në paragrafin e fundit të Shtojcës 7, të DST.

Për këtë arsye, LPP dhe rregullat e prokurimit nuk mund të lejojnë kualifikimin e një operatori ekonomik në rast se ai ka paraqitur dokumentacion të paplotë sipas kriterëve të përcaktuara nga vete autoriteti kontraktor. Keto qëndrime të ligjit dhe të rregullave të prokurimit, sa i takon trajtimin të kësaj ceshtje, kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e një procedure konkurruese prokurimi, pasi ato janë garante të zhvillimit të një gare të barabartë mes paleve (neni 2 I LPP).

Nga shqyrtimi dhe analiza e kësaj anekese, në fakt, nga subjekti ankimues kërkohej në thelb pikërisht pranimi i vertetimit si kontrate, duke qenë se në anekese pranohet edhe nga vete subjekti ankimues që dokumenti që konfirmon vlefshmerinë vijuese pas datës 15.01.2021 është një vertetim, pasi vete ankuesi ka paraqitur me anekesën e tij një konfirmim të tillë. Në sa më sipër, si dhe duke patur parasysh kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se operatori ekonomik ankimues ka deshtuar të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor për të paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, që provon se kontrata e lidhur me një landfill për depozitimin e produktin final, është e vlefshme për 12 muaj nga momenti i hapjes së ofertave.

Nga sa më lart ankimi i OE Medi Tel për këtë pikë nuk qëndron.

2. Në lidhje me ankimin e OE Medi Tel për skualifikimin e tij për mosplotësim të rregullt të Shtojcës I “formulari i ofertes”:

Formulari i ofertes, nga operatori ekonomik “Medi Tel”, është paraqitur ze për ze, ndërkohe që duke patur formatin e shtojcës nr 1, është kërkuar të paraqitet oferta për totalin e kilogramëve, duke qenë se sasitë janë të përafërta dhe nuk janë dhënë fiks, dhe formulari i ofertes në këtë formë mund të sjellë dem ekonomik për AK gjatë zbatimit të kontratës duke qenë se ndonjëri nga zerat me cmim më të lartë mund të ketë sasi më të madhe nga sa është parashikuar, çka do të rriste cmimin e kontratës. Shtojcën nr.1 e kemi si më poshtë:

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
1	Evadim dhe trajtim i mbetjeve spitalore (Mbetje infektive te ngurta +Mbetje te mprehta+ Mbetje patologjike.)	<ul style="list-style-type: none"> - Anatomo-patologjike - KODI 18 01 02 ~ 200 kg - Te mprehtat - KODI 18 01 01 ~ 3000 kg - Infektive - KODI 18 01 03 ~ 4800 kg <p><i>Te buta te pergj.</i> 18 01 04 ~ 2000 kg</p> <hr/> <p style="text-align: center;">Total 10.000 kg</p>			24 muaj
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Ne shtojcen nr.1, si më lart shikohet qe kemi vetem 1 ze, per nje sherbim dhe jo disa ndaj dhe oferta duhet te paraqitet vetem per ze sherbimi dhe per disa, ai ze eshte 1 ndare ne disa nen zera dhe jane dhene ne sasi te peraferta. Gjithashtu ne shtojcen nr.1 shihet qe jane disa zera qe jane pjese perberese e zerit numer 1, nese nuk do te ishte keshtu do te kishim dhe zerin 2, 3 dhe 4, por duke qene se keto zera mungojne rrjedhimisht oferta nuk eshte paraqitur ne menyren e kerkuar sipas shtojces nr.1. Edhe DST nuk eshte plotesuar pjesa që I perket sumatores se cmimit per njesi dhe rrjedhimisht eshte vetem njeze, nda formulari I ofertes I paraqitur nga OE Medi el eshte I parregullt. Nga sa me lart ankimi I OE Medi Tel per kete pike nuk qendron.

Ne rrethanat e mesiperme, KSHA vendosi se pretendimet e ankimuesit nuk qendrojne dhe merren ne konsiderate.

II.7. Në datën 10.11.2020 operatori ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1076 prot., datë 20.11.2020, protokolluar me tonën në datën 24.11.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me argumentin se “*OE Medi Tel sh.p.k. disponon një Akt-Marreveshje (kontratë) të lidhur me një landfill të licensuar (Integrated Technology BV SPV sh.p.k.) për depozitimin e produktit final që del nga trajtimi, e cila është aktive në momentin e hapjes së ofertave. Gjithashtu OE Medi Tel sh.p.k. bashke me akt – aktmarrëveshjen ka paraqitur edhe një vërtetim nr. 238 datë 10.08.2020 lëshuar nga Integrated Technology BV SPV sh.p.k. në të cilin citohet: “Shoqëria koncensionare “Integratek Energy Bv Spv” vërteton se rinovimi I kësaj akt – marrëveshje bëhet cdo vit nëse janë respektuar të gjitha kushtet e saj”.*

AK pretendon se paraqitja e vërtetimi nr. 238, date 10.08.2020 lëshuar nga Integrated Technology BV SPV, paraqitur nga Medi Tel sh.p.k., vërteton vlefshmërinë 1 vjecare nga momenti i lidhjes dhe nuk mund të merret si prove për te zgjatjen, apo premtim për lidhjen e një kontrate në të ardhmen, por është vetëm konfirmim i kontratës në fuqi mes palëve. Por në të vërtetë ky vërtetim vërteton pikërisht rinovimin e kësaj kontrate pas përfundimit të saj dhe vlefshmërinë e kësaj kontrate ekzistuese dhe jo sic është shprehur AK se vërteton vetëm vlefshmerinë e saj, kjo e verifikueshme lehtësisht duke lexuar vërtetimin nr 238 date 10.08.2020.

Gjithashtu Medi Tel sh.p.k. sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për tu siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”. Për këtë arsye argumentimi I AK nuk qëndron.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka modifikuar si më poshtë vijon:

1. Ne Piken 2.4.6 të Kapacitetit Teknik, behen keto ndryshime:

ISHTE:

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave dhe e vlefshme për minimalisht 24 muaj pas hapjes së ofertave (sa kohezjatja e marrëveshjes kuader).

BËHET:

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të paraqese nje kontrate te lidhur me nje landfill te licensuar per depozitimin e produktit final qe del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jete aktive ne momentin e hapjes se ofertave dhe e vlefshme per minimalisht 12 muaj pas hapjes se ofertave.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimes “Medi - Tel” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumentin Akt – Marrëveshje “Për depozitim mbetjesh pranë Z.T.M.T”, lidhur në datë 15.01.2020, midis “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. dhe “Medi-Tel” sh.p.k. me afat “/ (një) vjekar, me rinovim mujor të sistemit të faturimit per arsye fiskale”.
- Vërtetim Nr.238 prot., datë 10.08.2020 lëshuar nga “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. me përmbajtje si më poshtë: “Më datë 15.01.2020 ka lidhur akt – marrëveshjen e depozitimit me shoqërinë “Medi – Tel” sh.p.k. e cila gjatë mbarëvajtjes së punës së saj gjeneron mbetje të llojit spitalore të trajtuara të cilat i depoziton pranë venddepozitimit të Sharrës. Shoqëria koncesionare “Integrated Energy Bv Spv” vërteton se rinovimi i kësaj akt – marrëveshje bëhet cdo vit nëse janë respektuar të gjitha kushtet e saj. Gjithashtu vërtetojm se kjo akt – marrëveshje konsiderohet e vlefshme dhe aktive ndërmjet palëve”.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.4. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit ka kërkuar shprehimisht që “Operatori ekonomik duhet të paraqesë në kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave dhe e vlefshme për minimalisht 12 muaj pas hapjes së ofertave”.

Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes rezulton se, dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterit të mësipërm ka mangësi. Konkretisht, operatori ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k., për të vërtetuar se ka një kontratë të lidhur me një landfill për depozitimin e produktit final, ka paraqitur Dokumentin Akt – Marrëveshje “Për depozitim

mbetjesh pranë Z.T.M.T”, lidhur në datë 15.01.2020, midis “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. dhe “Medi-Tel” sh.p.k. me afat *“1 (një) vjekar, me rinovim mujor të sistemit të faturimit per arsye fiskale”*, si dhe Vërtetim Nr.238 prot., datë 10.08.2020 lëshuar nga “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. me përmbajtje si më poshtë: *“...Shoqëria koncesionare “Integrated Energy Bv Spv” vërteton se rinovimi i kësaj akt – marrëveshje bëhet cdo vit nëse janë respektuar të gjitha kushtet e saj. Gjithashtu vërtetohet se kjo akt – marrëveshje konsiderohet e vlefshme dhe aktive ndërmjet palëve”*.

Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit si dhe kërkesa e përcaktuar në kriterin e mësipërm, operatori ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur si mësipërm nuk arrin të përmbushë kriterin për një kontratë të lidhur me një landfill për depozitimin e produktit final, e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave, pasi aktmarrëveshja e mësipërme është lidhur midis palëve në datë 15.01.2020 dhe në të është përcaktuar afati *“1 (një) vjekar, me rinovim mujor të sistemit të faturimit per arsye fiskale”*, gjithashtu në vërtetimin Nr.238 prot., datë 10.08.2020 lëshuar nga “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. citohet se *“vërtetohet se kjo akt – marrëveshje konsiderohet e vlefshme dhe aktive ndërmjet palëve”*, fakt i cili nuk vërteton nëse kjo aktmarrëveshje është aktive në momentin e hapjes së ofertave apo jo, pasi vërtetimi është lëshuar nga shoqëria koncesionare në datë 10.08.2020, ndërkohë që hapja e ofertave të kësaj procedure prokurimi është kryer në datë 09.10.2020.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik “Medi – Tel” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, pasi nuk vërteton faktin që kjo aktmarrëveshje është aktive në momentin e hapjes së ofertave. Sa më sipër dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

III.1.6. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu,

kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm e, rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Sa më sipër, KPP sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Medi - Tel” sh.p.k. mbi arsyet e tjera të skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-68090-08-09-2020, me objekt “*Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore*” - *Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (24 muaj)*”, me fond limit 4.800.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Krujë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1463 Protokolli

Datë 10.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri